REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 49/17, 52/17
Datë/Datum. 09.03.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT - TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI - PROCUREMENT REVIEW BODY

T-S
G.M
B.D

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e prokurimit **Kuvendi i Kosovës**	Kopje:	Paneli Shqyrtues - OSHP
Prej:	Visar Basha – Ekspert shqyrtues i prokurimit		
Lënda:	Ekspertiza lidhur me Ankesën Nr. **49/17** te OE **"Luzern"** dhe ankesën me nr. **52/17** te OE ankues **"Shqiponja"**.		
Datë:	09.03.2017		

Bazuar në nenin 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 të Prokurimit Publik të Kosovës ju njoftojmë me raportin e ekspertizës, lidhur me ankesën e parashtruar me dt: 20.02.2016 me Nr. **49/17** nga OE **"Luzern"** – Prishtinë dhe ankesën e parashtruar me dt: 22.02.2016 me Nr. **52/17** nga OE **"Shqiponja"** - Drenas, për shqyrtimin e lëndës: **"Shërbime te hotelerisë në Kuvendin e Republikës së Kosovës"**, me numër të prokurimit: 101/16/201/211, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Kuvendi i Kosovës.**

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.

Ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KUVENDI I KOSOVËS.**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP.**
- OE ankues – **LUZERN dhe SHQIPONJA.**

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

		27.02.2017		**27.02.2017**		**09.03.2017**
Nënshkrimi i ekspertit		*Data e autorizimit të eksp.*		*Data e fillimit të ekspertizës*		*Data e dorëzimit të raportit*

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën 20.02.2017, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesën me nr. 49/17 e parashtruar nga OE **"Luzern",** me seli në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Shërbime te hotelerisë në Kuvendin e Republikës së Kosovës"**, me numër të prokurimit: 101/16/201/211, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Kuvendi i Kosovës.**

Me datën 22.02.2017, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesën me nr. 52/17 e parashtruar nga OE **"Shqiponja",** me seli në Drenas, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Shërbime te hotelerisë në Kuvendin e Republikës së Kosovës"**, me numër të prokurimit: 101/16/201/211, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Kuvendi i Kosovës.**

Konform nenit 113 te Ligjit Nr. 04/L-042, Eksperti Shqyrtues e ka shqyrtuar dhe analizuar lëndën e (AK) – **Kuvendit të Kosovës.**

N.111 i LPP-së - Operatori Ekonomik Ankues:

Pikat e Ankesës nga OE **"Luzern"** *- dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues:*

Neni 7 – Barazia në trajtim / jo Diskriminimi;
Neni 59 – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve;
Neni 60 – Kriteret për dhënie të kontratës;
Neni 61 – Tenderët jo-Normalisht te ulët.

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

Në vazhdim ju prezantojmë pikat e ankesës nga ana jonë, për shkeljet e Autoritetit Kontraktues- të udhëhequr nga Departamenti i Prokurimit, për tenderin "Shërbime të hotelerisë në Kuvendin e Republikës së Kosovës", duke na eliminuar dhe anuluar këtë aktivitet të prokurimit me arsyetimin se Një dispozitë në Ligjin e Prokurimit Publik kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit, nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përgjegjshme :

- Autoriteti Kontraktues, me këtë veprim ka shkelur nenin 7 i Ligjit të Prokurimit Publik - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi, sepse duke na eliminuar dhe anuluar këtë aktivitet të prokurimit, na ka trajtuar të pabarabartë dhe na ka diskriminues me këtë veprim, sepse kompania "Luzern" ka ofruar tenderin e përgjegjshëm sipas kërkesave në Njoftimin për kontratë dhe Dosje të tenderit.
- Autoritetit Kontraktues na ka eliminuar pa të drejtë nga ky aktivitet i prokurimit, kështu që e ka shkelur nenin 59 i Ligjit të Prokurimit Publik (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve), sepse gjatë Vlerësimit të Tenderëve përmes letrës standarde ka kërkua nga ne informata mbi tenderët jo-normalisht te ulte dhe ne në pajtueshmëri me afate ligjore kemi dërguar shkresën dhe kemi dhënë sqarimet e mjaftueshme lidhur me arsyeshmërinë e ofertës me çmimin "jo-normalisht te ulte" , mirëpo Autoritet Kontraktues pa të drejtë nuk e ka marre

për baze arsyetimin tone duke refuzuar ofertën tone.

- Është shkelur neni 60 i Ligjit të Prokurimit Publik- (Kriteret për Dhënien e Kontratës), përkatësisht Dosja e tenderit Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), Kriteret e Dhënies, Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar : tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët - Çmimi me peshim; Këtu Autoriteti Kontraktues, nuk e ka respektuar kriterin e dhënë për të na shpallur neve fitues, sepse nga ofertat e dorëzuar për këtë tender kemi dorëzuar tender të përgjegjshëm me çmim më të ulët. Me rastin e qasjes në dokumenti e kemi konstatuar se ne kemi ofertuar me çmime të tregut, sepse kompania tjetër "Shqiponja", me çmim mët ë ulët se ne, në Listën e Çmimeve i ka më tepër se 30 artikuj me çmime jo normalisht të ulët dhe me të drejtë është eliminuar.
- Autoritetit Kontraktues ka shkelur Nenin 61 i Ligjit të Prokurimit Publik (Tenderet Jo-Normalisht te Ulet).

Pas marrjes së Letrës Standarde të kërkesës për informata mbi tenderët jonormalisht te ulet, ne i kemi dorëzuar sqarimet dhe përgjigjet e nevojshme duke argumentuar ofertën te cilën e kemi ofruar, kemi shprehe gatishmëri qe ofrojmë dëshmi lidhur me stafin, seriozitetin e punës, prezantimin e kontratave te cilat i kemi përfunduar me sukses për të cilat kemi të bashkëngjitur referencat për përfundim të suksesshëm të tyre, sepse objektivi ynë është finalizimi i shërbimit dhe kontratës me referenca pozitive si qellim primar, jemi pajtuar nëse na kërkohet te rrisim sigurinë e ekzekutimit ne pajtueshmëri me ligjin e prokurimit publik për te dëshmuar qe jemi të gatshëm dhe serioz në përmbushjen e kësaj kontrate, por nuk është marrë për bazë dhe jemi eliminuar. Ne si kompani për këtë shërbim e kemi analizuar Listën e çmimeve dhe ju kemi kthyer përgjigjeje dhe sqarime, se çmimet e ofruara janë reale, çmime të tregut gati ne te gjitha pozicionet te klasifikuara ne dosje te tenderit, me emërtimin dhe ndarjen si vijon:

- Pije te nxeta(1-11)
- Ushqim(1-16) dhe
- Ushqim e pije me porosi te veqanta(1-25).

Lista e çmimeve përfshin në vete rreth 52 artikuj, kjo i bie qe përmbi 90% e ofrimit te Çmimeve nga ana e kompanisë, janë reale dhe te arsyeshme, kjo ka bere qe ne të kalkulojmë disa artikuj që kanë kosto më të ulët të shpenzimeve, me çmim më të ulçt, e që Autoriteti Kontraktues i ka konsideruar si çmime jo-normalisht të ulët.

Duke u mbështetur në Nenin 61 të LPP. Tenderët Jo-Normalisht të Ulët paragrafin 2.1 citojmë (çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicion për tenderuesin për furnizimin e produkteve, sigurimin e shërbimeve, ekzekutimin e projekteve të punëve dhe/ose ushtrimin e aktiviteteve të ndërtimit që janë duke u prokuruar;

I kemi dhënë shpjegime detale në lidhje me bazën e tenderit, sipas paragrafin 2. të këtij neni (61), se duke e marrë parasysh dhe bazuar në lehtësimet që ofrohet me kryerjen e këtyre shërbimeve në hapësirën e Autoritetit Kontraktues, pasi nuk përfshihen: qiraja, kostot e rrymës, ujit, mbeturinave etj, se nuk janë çmime obnormalisht të ulëta, për ata pak artikuj që kan menduar se janë të ulët, duke filluar prej pozicionit në vijim:

- Kapuçino në përbërjen e saj ka rreth 85% shkume qumështi, e që ne fakt kosto e shpenzimit është jashtëzakonisht i ulet sepse shkuma e qumësht nuk përmban ne vete kosto-shpenzim.
- Sa i përket pozicionit te omletëve dhe hamburgerit me çmim 0.70 cent, NUK

KONSIDEROJME qe është çmim jo-normalisht i ulet sepse janë ekuivalent me çmimin në treg.

- Te pozicionet bambi, verërat, kashkavall, shpageta, file peshku-i kemi futur si artikuj që nuk ndikojnë në shpenzimet jo te përballueshme për ne, si total i të gjitha qmimeve dhe kontratës. Nga kjo shihet se ne kemi ofertuar me çmime reale, ku këtë e dokumenton edhe renditja e kompanisë sonë ne bazë të çmimit.

Pas shpjegimeve dhe argumenteve tona, Autoriteti Kontraktues, nuk ka bërë përpjekje minimale për te hulumtimin dhe shqyrtimin e elementeve te rëndësishme qe shkaktojnë tenderin veçanërisht të ulët, duke anashkaluar gatishmërinë tonë, duke mos kërkuar dokumentet dhe sqarime shtesë, nuk e ka shfrytëzuar të drejtën ligjore si komision për të na ftuar apo për të ardhur ne zyret tona, për shqyrtim më të detajuar të ofertës tonë në kalkulimin e çmimeve.Eliminimi i kompanisë tonë, me arsyetimin se shpjegimi (arsyetimi i dhënë) nga ne nuk eshte i mjaftueshëm per Autoritetin Kontraktues e konsiderojmë te pa drejtë, i pa bazuar dhe i mbështetur ne paragjykime.Andaj, pas këtyre argumenteve të prezantuara më lartë, për parregullsitë dhe shkeljet e cekura nëpërmjet kësaj ankese, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit, ta aprovoj ankesën tonë, të marr vendim mbi anulimin e njoftimit mbi anulimin e aktiviteti i prokurimi për tenderin "Shërbime të hotelerisë në Kuvendin e Republikës së Kosovës"dhe i njëjti të kthehet në Ri vlerësim.

Pikat e Ankesës nga OE **"Shqiponja"** - *dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues:*

Neni 1 - Qëllimi;
Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti;
Neni 56 - Dispozitat e përgjithshme mbi përzgjedhjen e pjesëmarrësve dhe dhënien e kontratave;
Neni 59 – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve;
Neni 61 – Tenderët jo-Normalisht te ulët;
Neni 62 – Përfundimi i aktivitetit te prokurimit.

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

Në vazhdim të kësaj Ankese do të përpiqemi që të argumentojmë shkeljet e pretenduara të:

1. Të dispozitave të LPP-se në RK.

Neni 1. Qëllimi

Komisioni për vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit me vendimin e vet për të eliminuar nga aktiviteti i mëtejmë i prokurimit si dhe anulimin e aktivitetit te prokurimit, ka vepruar ne kundërshtim me neni 1, paragrafin 1 te LPP-se ne Republikën e Kosovës.

Sipas nenit 1 , paragrafit 1 të këtij Ligji, Zyrtaret e prokurimit janë të obliguar që gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit të kujdesen për qëllimin e këtij Ligji.

Duke pasur parasysh këtë fakt ne pretendojmë se AK ka vepruar ne kundërshtim me qëllimin e këtij ligji.

Në vijim po citoj dispozitat e Nenit 1. Paragrafi 1 të këtij ligji.

" Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të

autoriteteve kontraktuese ne Kosovë"

- **Neni 6, Ekonomiciteti dhe Efikasiteti**

Pretendojmë se Komisioni për vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit me vendimin e vet për ta anuluar këtë aktivitet të prokurimit me të vetmin arsyetim se nuk ka oferta të përgjegjshme ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 6 të LPP-se.Në vijim po citoj dispozitat e nenit 6. paragrafi 1 te këtij ligji.

1. Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.Pretendojmë se Kuvendi i Kosovës ka dështuar ne zbatimin e obligimit te parapare me ligj qe te siguroj qe fondet publike te përdorën ne mënyrë ekonomike duke refuzuar ofertën e kompanisë sonë si oferte me çmim jo normalisht te ulte.

Neni 56, Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave

Pretendojmë se Komisioni për vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit ka vepruar ne kundërshtim me neni 56, paragrafin 1.1 dhe paragrafi 1.2 te LPP-se ne Republikën e Kosovës.Ne vijim po citoj dispozitat e nenit 56. paragrafi 1.1 dhe 1.2 te këtij ligji

Të gjitha kontratat publike do të jepen, sipas procedurave të themeluara për një seleksionim të tillë, dhe përmes:

1.1. Së pari, vlerësimit të tenderëve dhe kandidatëve sipas kërkesave të kualifikimit të specifikuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit sipas paragrafit 2. të nenit 51 të këtij ligji, dhe tenderëve sipas specifikimeve teknike të kërkuara në bazë të nenit 28 të këtij ligji;40

1.2. Së dyti, vlerësimi i tenderëve në përputhshmëri të kritereve të vendosura në nenin 6o të këtij ligji.

Pretendojmë se Komisioni për vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit ka dështuar në kualifikimin dhe përzgjedhjen e operatoreve ekonomik konformë kushteve formale administrative të pjesëmarrjes në tender të përcaktuara në njoftimin për kontrate dhe në dosjen e tenderit dhe me këtë rast ka shkel nenin 56 të LPP-së.

Neni 59, Vlerësimi ekzanainimi dhe krahasimi

Pretendojmë se Komisioni për vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit me vendimin e vet për të trajtuar ofertën e kompanisë NTH "Shqiponja" si oferte me çmim jo normalisht të ultë dhe si rrjedhojë e kësaj të marr vendim për eliminimin nga aktiviteti i mëtejme i prokurimit ka vepruar në kundërshtim me neni 59, paragrafin 2, dhe 4 te LPP-se ne Republikën e Kosovës.Në vijim po citoj dispozitat e nenit 59. paragrafi 2 dhe 4 të këtij ligji:

2. Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të Sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues. - -

4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspekin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i

tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

Pretendojmë se Komisioni për vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit ka dështuar në vlerësimin ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit, duke vlerësuar gabimisht ofertën tone si oferte me çmim Jo-Normalisht të ulte edhe përkundër sqarimeve te dhëna mbi arsyeshmerine e çmimit të dhëne ne ofertën financiare.

Komisioni për vlerësimin ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e këtij në ligji në momentin kur ka vlerësuar se tenderi i kompanisë sonë" NTH Shqiponja " është i pa përgjegjshëm sepse tenderi i jone ka qen dhe është në përputhshmëri të plotë me të gjitha kërkesat e parashtruara në dosjen e tenderit. Të ju përkujtojmë se kërkesat për kualifikim dhe përzgjedhje të OEjanë të përcaktuara në Njoftimin për kontrate dhe në FIDT të dosjes së tenderit.Me fjalë të tjera ne kemi plotësuar kërkesat minimale kualifikuese te përcaktuara ne dosjen e tenderit, paragrafi 7,8, 9 13 dhe 14 përkatësisht kërkesat e përcaktuara në LPP-së, në nenin 65, 66, 68 dhe 69 të LPP-së.Në paragrafin 27 të Informacioneve per tenderuesit te dosjes se tenderit ne mënyrë detale është e parashikuar vlerësimi dhe ekzaminimi, krahasimi i tenderit. Citoj dispozitat e këtij paragrafi;

27.1 Tenderët e pranuar me kohë do të ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen në bazë të procedurës së përcaktuar në Rregulloren e Prokurimi Publik.

27.2 Tenderi konsiderohet të jetë i përgjegjshëm kur:

- është në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të

kësaj dosjeje të tenderit;

- është në pajtueshmëri në termet teknike me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në këtë dosje të tenderit;
- është dorëzuar nga operatori ekonomik që përmbush kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në këtë dosjeje të tenderit.

Të qenët "në pajtueshmëri" nga aspekti administrativ dhe teknik duhet të kuptohet si përmbushje e kërkesave dhe e specifikimeve administrative dhe teknike të parashtruara në këtë dosje të tenderit duke mos u larguar substancialisht nga to dhe duke mos u bashkangjitur atyre kufizime.

Duke pasur parasysh këto fakte pretendojmë se tenderi i jone ka qen ne përputhshmëri te plote me paragrafin a,b, dhe cte dosjes se tenderit.

- ***Nenit 61 , Tenderët Jo-Normalisht te ultë***

Pretendojmë se Komisioni për vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit i AK - Kuvendit te Kosovës ka bërë shkelje te dispozitave të nenit 61, paragrafi 3, të LPP-së dhe me ketë rast ka dështuar në vlerësimin ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit, duke vlerësuar ne kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik, ofertën tone si oferte me çmim Jo-Normalistë të ulte si dhe ofertat tjera te operatoreve ekonomik edhe përkundër sqarimeve te dhëna mbi arsyeshmërin e çmimit të dhëne në ofertën financiare. Konstatimi i Komisionit se nuk kane ofruar sqarime bindëse lidhur me arsyeshmerine e çmimit te dhëne është ne kundërshtim me nenin 61 të LPP-së.

LPP ne RK ne nenin 61 - në mënyre detale parasheh kushtet te cilat duhet të plotësohen në mënyrë që të kualifikohet një tender si tender me çmim Jo -Normalisht të ultë.

Nëse i referohemi Raportit te Komisionit per vlerësimin ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit te datës 23.12.2O16 do te shohim se arsyeja e eliminimit te këtij tenderi është se te gjithë operatoret ekonomik te cilët kane marre pjese ne këtë tender janë shpallur si tender me çmim jo-normalisht te

ulte.

Pretendojmë se AK – Kuvendi i Kosovës ka dështuar në vlerësimin ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit, duke vlerësuar gabimisht ofertën tonë si ofertë me çmim Jo-Normalisht të ultë edhe përkundër sqarimeve të dhëna mbi arsyeshmrinë e çmimit të dhëne në ofertën financiare. Pretendojmë se oferta e jon ka qen ofertë reale dhe e bazuar në çmimet reale në tregun e Kosovës.

- ***Nenit 62, Përfundimi i Aktivitetit te prokurimit***

Pretendojmë se Komisioni për vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit i AK – Kuvendit të Kosovës ka bërë shkelje te dispozitave të nenit 62, paragrafi 2, të LPP-së përkitazi me arsyen e anulimit te këtij aktiviteti te prokurimit.LPP ne RK ne nenin 62 të LPP-së rregullon në mënyre detale dhe parasheh kushtet qe duhet te plotësohen me rastin e përfundimit te një aktiviteti te prokurimit.

Nëse i referohemi Njoftimit per anulimin e këtij tenderi do te shohim se arsyeja per eliminim është ne kundërshtim me nenin 62 te LPP-se :

X. Një dispozitë në Ligjin e Prokurimit Publik kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit:

II. Shkeljet e supozuara të UOPP -Rregullave për tenderët Jo-normalisht të ultë

- **Neni 42, Tenderët Jo-normalisht të ultë**

Pretendojmë se Komisioni për vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit i AK - Kuvendit të Kosovës ka dështuar në zbatimin e nenit 42 të UOPP përkatësisht të Rregullave për tenderët Jo-Normalisht të ulte. Sipas nenit i këtyre Rregullave , AK. Kuvendi i Kosovës ka dështuar në zbatimin e tyre sepse qëllimi i këtyre rregullave është qe te jepen sqarime në lidhje me konceptin e tenderit jo-normalisht të ultë.Nëse i referohemi nenit 3 të këtyre Rregullave atëherë do te shohim dhe se nuk janë plotësuar asnjë kusht per ta trajtuar ofertën tone pra te NTH "Shqiponja" si oferte me çmim Jo-normalisht te ulte. Nëse i referohemi Raportit te Vlerësimit te tenderit te datës 23.12.2O16 do te shohim se nga 6 operator ekonomik qe kane marre pjese ne tender sipas vlerësimit te Komisionit vetëm tre operator ekonomik kane qen te përgjegjshëm ne pikëpamje te plotësimit te kushteve formale administrative te pjesëmarrjes ne tender.Pra tender te pergjegjehem kane qen:

- NTH " Shqiponja" me çmim mesatar per njësi 8.96 euro
- DPH" Lucern" me çmim mesatar per njësi 11.62, dhe
- "Beni Dona Plast" sh.p.k me çmim mesatar per njësi 13.96 euro.

Ne rastin konkret nëse e aplikojmë nenin 3.1 paragrafi " i " , do te shohim se çmimi mesatar është 34.54 te cilin e pjesëtojmë me 3 atëherë çmimi mesatar efshte 11.51 euro. Këtij çmimi i zbresim -30 % do te shohim se çmimi do te jete 8.05 euro Ndërkaq Oferta e jene është 8.96. euro.

Pra ne këtë rast është dashur te aplikohet Rregulli i tenderit jo-normalisht te ulte dhe te merret mesatarja e Ofertave financiare dhe te aplikohet neni 3.1, paragrafi i - Çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm;

Ne vijim po i citoj dispozitat e nenit 3 paragrafi 1 dhe 2, të Rregullave;

3.1 Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar, kur të përmbushen te gjitha kushtet e mëposhtme:

- çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të

  përgjegjshëm

- çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët,
- janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë.

3.2 Kur tenderët duken të jenë jo-normalisht te ulët për arsye të tjera nga ato te parashikuara në paragrafin 3.1 të këtyre rregullave, autoritetet kontraktuese mund të vlerësojnë besueshmërinë e tenderëve të tille dhe rrjedhimisht të kërkojnë shpjegime në përputhje me paragrafët e mëposhtëm dhe nenin 61 të LPP-së. Duke pasur parasysh këto fakte ne pretendojmë se AK-Komisionin per Vlerësimin Ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit ka vepruar ne kundërshtim me nenin 42 te UOPP-Rregullave për tenderët Jo-normalisht të ultë.

Duke pasur parasysh këto fakte kërkojmë nga organi kompetent i AK-Kuvendi i Kosovës që:

- Të aprovoj ankesën si të bazuar
- Të anuloj, Vendimin per refuzim te Kërkesës per rishqyrtim te vendimit,

Vendimin për eliminimin nga aktiviteti i prokurimit dhe

- Vendimin për anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit per tenderin:

Shërbime hoteliere në Kuvendin e Republikës se Kosovës dhe

- Të kthej tenderin në rivlerësim dhe vlerësimi të bëhet në pajtim me kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë dhe në FDT të dosjes së tenderit.

Mbetemi me shprese se Ankesa e jone do të shqyrtohet pozitivisht.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë në KRPP : 11.08.2016

Lloji i procedurës së aplikuar:..... Procedurë e hapur

Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar: .....Shërbime/vlerë e madhe

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave (gjithsejtë ditë): 22.12.2016

Data e hapjes së ofertave .....22.12.2016-14:00^{h}

Kriter për dhënie të kontratës:.....*Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët*

Lloji i kontratës:.....*Kontratë kornize – 36 muaj*

Kriteret për vlerësim

III.2)KUSHTET PËR PJESËMARRJE

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:

1. Deklarata nën betim se operatori ekonomik I përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë sipas LPP nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 – forma: Aneksi 2, dosja e tenderit.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Deklaratë nën betim (Origjinal).

2.Vërtetim nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit.
2. Një vërtetim nga Administrata Tatimore.
3.Vërtetimin nga Gjykata- Një dokument te lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush "Kërkesat e pershtatshmerise"- te jete i lëshuar se paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit –origjinal/kopje e noterizuar.
3. Vërtetimin nga Gjykata -origjinal ose kopje e noterizuar. (vetëm për fituesin)

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:
1. Operatori ekonomik duhet të jetë I regjistruar në regjistrin profesional, komercial dhe/ose të korporatës në shtetin e themelimit të operatorit ekonomik.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:
1. Certifikatë e regjistrimit të biznesit- me numër fiskal (kopje).
2.Operatori ekonomik duhet të ketë certifikatë të TVSH-së
2.Certifikata e TVSH-së (kopje).

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:
1.Operatori Ekonomik duhet të ketë qarkullim në tri vitet e fundit (2013, 2014, 2015) në total jo më pak se 380,000.00 euro.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:
1. Kopjet e raporteve financiare (për tri vitet e fundit 2013, 2014, 2015) të certifikuara nga një irmë e njohur e licencuar për kontrollim apo një auditor i licencuar i pavarur ose Kopjet e Deklaratave Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore te Kosovës për tri vitet e fundit (2013, 2014,2015).

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:

1.Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së njëjtë (shërbime të hotelerisë - gastronomisë) të përcjella me referenca në 3 (tri) vitet e fundit (2013, 2014, 2015), në total në vlerë jo më pak se 280,000.00 €.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:
Një listë e cila paraqet secilën nga kontratat e shërbimeve të njëjta (shërbime të hotelerisë - gastronomisë) të përfunduara në 3 (tri) vitet e fundit (2013, 2014, 2015), ku specifikohet: Data e përfunduar, lloji I shërbimeve të përfshira, pranuesi i shërbimeve, shuma e kontratës.
• Referenca për këto kontrata të përfunduara (në referencë duhet të jetë e shënuar edhe vlera e përfunduar e kontratës), në total jo më pak se 280,000.00 €.

2. Operatori ekonomik duhet të caktojë një person menaxhues:
•Menaxher i kontratës ..... 1.

Dëshmitë për kërkesën nr. 2.
• Vendimet me shkrim mbi caktimin e Menaxherit të kontratës origjinal I nënshkruara dhe I vulosura nga operatori ekonomik, të cilave u bashkëngjiten kopjet e dokumenteve në vijim:
o Diploma ose certifikata
o CV
o Kontrata e punës me operatorin ekonomik.
o Dëshmitë (kontratat e punës) për përvojën e punës (së paku 5 vjet) në lëmin e

shërbimeve të hotelerisë.
3. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar si në vijim:
1) Kuzhiner 2
2) Ndihmës kuzhinier 1
3) Banakier 1
4) Kamarier 7
• Kuzhiner duhet të keni 3 (tri) vite përvojë pune, ndihmës kuzhinier dhe banakier duhet të keni 2 (dy) vjet përvojë pune,dhe kamarier me 1 (një) vit përvojë pune.

Dëshmitë për kërkesën nr. 3
• Listen e Stafit: Emri, mbiemri, numri I letërnjoftimit, duhet të dorëzohet në origjinal, e nënshkruar dhe e vulosur nga Operatori Ekonomik.
Dëshmitë (kopje) për stafin e kërkuar pozita 1) dhe 2)
• Diploma ose certifikata
• CV
• Kontrata me afat validiteti të krijimit të marrëdhënies së punës
Dëshmitë (kopje) për stafin e kërkuar pozita 3) dhe 4)
• CV
• Kontrata me afat validiteti të krijimit të marrëdhënies së punës.

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr	Operatoret ekonomik	Vendi	Çmimi total për njësi €	Vërejtje
1.	"Luzern"+	Prishtinë	11.62€	JO
2.	"Ushqimi"+	Obiliq	7.76€	JO
3.	"Global Parajsa"+	Vushtrri	13.38€	JO
4.	"Shqiponja"+	Drenas	8.96€	JO
5.	"Fast Food"+	Prishtinë	11.02€	JO
6.	"Beni Dona"+	Prishtinë	13.96€	JO

Komisioni vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues.

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje prej tre anëtarëve, si në vijim:

- Hajrije Hajredinaj - Kryetar i komisionit
- Naser Uka - Anëtar i komisionit
- Mehmet Simnica - Anëtar i komisionit

Data e mbarimit të vlerësimit: 03.02.2017

Data e nënshkrimit te raportit nga zyrtari kryesor i prokurimit:.....06.02.2017

Data e njoftimit për Anulim të aktivitetit te prokurimit në faqen e Krpp-së :.....09.02.2017

Raporti i komisionit vlerësues:
Komisioni rekomandon drejtorin e prokurimit te anuloj procedurën për arsye se nuk kemi asnjë ofertë te përgjegjshme.

Neni 54 i LPP-së – Njoftimi i kandidatëve - Tenderuesve

AK-ja, konform nenit 54 të LPP-së dhe nenit 37 të Udhëzuesit Operativ për Prokurimit Publik, i njofton operatorët ekonomik me letrën standarde.

Neni 108/A - Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

Pas pranimit të letrës standarde OE-te ankues konform nenit 108/A ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim, me ç'rast AK-ja, i refuzon te dy ankesat si të pa bazuara.

Përgjigjet e ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimet ankimore të OE ankues:

Sqarimi nr.1

Eksperti shqyrtues, sqaron se te dy OE-te ankues eliminohen nga ky aktivitet i prokurimit me arsyetimin se kanë ofruara çmime Jo-Normalisht te ulëta.
Konkretisht eksperti shqyrtues, sqaron se AK-ja, lidhur me ofertën financiare te OE ankues "Shqiponja" ka kërkuar te jap sqarime për 33 pozicione te cilat AK-ja, i ka vlerësuar si çmime Jo-normalisht te ulëta (Kafe Kapucino ka dhënë çmim prej: 0.10 euro/cent, pastaj Qumësht Qokollad (bambi) ka dhënë çmim prej: 0.10 euro/cent).

Poashtu, edhe ne lidhje me ofertën e OE ankues "Luzern", AK-ja, konform nenit 61 te LPP-se, ka kërkuar sqarime lidhur me artikujt e njejt (Kafe Kapucino ka dhënë çmim prej: 0.10 euro/cent, pastaj Qumësht Çokollatë

(bambi), sikurse te OE "Shqiponja" i cili ka ofruar poashtu çmime te njëjta për te dy produktet e lartpërmendura.

Pas kërkesës së AK-se, drejtuar te dy OE-ve, te njëjtit kane kthyer përgjigje brenda afatit te parapar nga AK-ja,
AK-ja, poashtu ne lidhje me mime Jo-Normalisht te ulëta, ka kërkuar sqarime edhe nga OE-te tjer pjesëmarrës ne këtë aktivitet te prokurimit.

Sqarimi nr.2

Eksperti shqyrtues, sqaron se pergjigjet e dhena nga OE-te, nuk kane qene bindese per autoritetin kontraktues, andaj pretendimet ankimore te OE-ve ankues jane te paqenrueshme per faktin se sipas neni 61 paragrafit 4, thuhet se: Pas marrjes parasysh të informacioneve dhe sqarimeve të dorëzuara nga tenderuesi sipas paragrafit 1. të këtij neni, nëse autoriteti kontraktues vendos se tenderi është jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të refuzojë tenderin. Andaj, eksperti shqyrtues sqaron se sipas paragrafit 4 te nenit 61 te LPP-se, eshte e drejt e autoritetit kontraktues vlerësimi i cmimeve te ofruara nga OE-te.
Gjithashtu sa i perket pretendimit te OE ankues "Luzern", se AK-ja, nuk e ka respektuar rregulloren per cmime Jo-Normalisht te ulëta, eksperti shqyrtues sqaron se pavarësisht rregullores se lartpërmendur AK-ja, është e obliguar qe te respektoj nenin 61 te Ligjit per Prokurim Publik.

Sqarimi nr.3

Eksperti shqyrtues, sqaron se pretendimet ankimore për shkelje te dispozitave te LPP-se te parashtruara ne ankes jane te paqensrueshme per faktin se sic u cek edhe me lart vlerësimi i cmimeve sipas paragrafit 4 te nenit 61 te LPP-se i takon autoritetit kontraktues, ndersa ne lidhje me pretendimin

se eshte shkelur neni 7 i LPP-se, eksperti shqyrtues nuk ka vërejtur trajtim te pa barabart te OE-ve pjesmarres ne kete aktivitet et prokurimit.

Mendimi i ekspertit shqyrtues :

- Eksperti shqyrtues bazuar në konstatimet e cekura në ekspertizë mendon që Autoriteti Kontraktues – **Kuvendi i Kosovës**, për aktivitetin e prokurimit **"Shërbime te hotelerisë në Kuvendin e Republikës së Kosovës"**, me numër të prokurimit: 101/16/201/211, nuk i ka respektuar në tërësi dispozitat e LPP-së.
- Prandaj eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ta aprovojë vendimin e AK-së, për anulim te aktivitetit te prokurimit dhe njëherit i propozon panelit shqyrtues që ankesat e OE-ve ankues te refuzohen si te pa bazuara.